



Buletini nr. 161- Prill- 2017- Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Buletini nr. 161- Prill- 2017- Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Fillimi i ndërtimit të pesëdhjetë serrave për fermer



Dhënia e shujtës për nxënësit e shkollave fillore

Përmbajtja:

Këshilli i Drejtorëve, mbajti mbledhjen e rregullt.....	3
Begaj, priti udhëheqësin e KREK-ut, A.Hasanaj	3
Kryetari Begaj, priti udhëheqësin e ri të LMT-së në Malishevë.....	4
Prej nesër, fillon trajtimi i qenve endacak	4
Sot filloi aksioni i trajtimit të qenve endacak	5
Komuna në aksion për pastrimin e qytetit	6
Infrastruktura e shkollës në Bellanicë, drejt përfundimit.....	7
Kryetari Begaj, vizitoi disa nga pemëtarët lokal	8
Kryetari Begaj, priti zyrtarët e OSBE-së	8
Filloi rregullimi i këndit të lojërave në parkun e qytetit	9
Familja Kastrati në Turjakë, bëhet më shtëpi banimi	10
Filloi realizimi i dhënies së shujtës për nxënësit e shkollave në Malishevë.....	11
Komiteti për Politikë dhe Financa, mbajti mbledhjen e pestë për këtë vit	11
Përurohet fusha e sportit në Llapçevë.....	12
Begaj e Zharku, nënshkruan një marrëveshje për financimin e dy projekteve	13
Mexhid Foniqi, falënderoi kryetarin Begaj, për përkrahjen e dhënë për komunitetin e të verbërve	13
Filloi ndërtimi i 50 serrave	14
Kryetari Begaj, priti në takim pune, zyrtarët e KEDS-it.....	15
KK i Malishevës, kërkon ndërprerjen e privatizimit dhe hetimin e procesit privatizimit të deritanishëm	15

Këshilli i Drejtorëve, mbajti mbledhjen e rregullt

Malishevë, 3 prill

Këshilli i Drejtorëve, i drejtuar nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka mbajtur sot mbledhjen e rregullt të së hënës, ku është raportuar për aktivitetet e drejtorive komunale, gjatë javës së kaluar dhe planifikimet për javën në vijim. Në këtë mbledhje, u tha se po vazhdon realizimi i projekteve, sipas planifikimeve, dhe ecuria e këtyre projekteve është duke shkuar mirë dhe rrjedhimisht edhe realizimi i tyre do të bëhet sipas planifikimeve.

Temë me rëndësi e trajtuar në këtë mbledhje është edhe problematika e qenve endacak, ku sipas drejtorit për bujqësi, Murat Hoxha, janë në bisedime me një fondacion zviceran, me të cilin pritet që gjatë javës të bëhet edhe një marrëveshje, për sterilizimi dhe kastrimin e qenve endacak.

Edhe drejtoritë tjera, kanë raportuar për aktivitete e tyre, ku u tha se po vazhdon me fushatat për luftimin dhe parandalimin e EHKK. Po ashtu edhe inspektorati ka njoftuar se gjatë kontrolleve të rregullta të lokaleve hoteliere, kanë hasur në dy raste, ku kanë gjetur probleme me dokumentacion për punëtorët e angazhuar në këto lokale, dhe si rezultat i kanë mbyllur dy lokale “nate”.

Begaj, priti udhëheqësin e KREK-ut, A.Hasanaj

Malishevë, 3 prill



Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, dhe drejtoresha për rini, Blerta Krasniqi, kanë pritur sot udhëheqësin e Këshillit të Rinisë Evropiane të Kosovës, Avdullah Hasanaj, me të cilin kanë biseduar për projektin e këtij këshilli, lidhur me reformën në administratën publike, me gjeneratën e re. Projekti i këtij këshilli, është “Rini në administratë, Fuqi për të ardhmen”.

Hasanaj, e ka njoftuar kryerin Begaj dhe drejtoreshën Krasniqi, me projektin e tyre, që sipas tij, bëhet në bashkëpunim dhe në harmoni me Bashkimin Evropian dhe bëhet në kuadër të Kuvendit të Kosovës, ndërsa i tërë

projekti do të zgjasë rreth dymbëdhjetë muaj, ku përfshihen një varg aktivitete, që lidhen me këtë projekt.

Kryetari Begaj, ka bërë të ditur se si komunë, e përkrahin rininë në aktivitetet e tyre, si dhe mundohen që përmes aktiviteteve të komunës, të krijojnë kushte që rinia të mbetet këtu, dhe ti shprehin dhe realizojnë idetë e tyre në raport me zhvillimin e vendit dhe fuqizimin e rinisë në përgjithësi.

Drejtoresha Blerta Krasniqi, ka shprehur gatishmërinë, për fuqizimin e të rinjve që punojnë në administratën publike.

Kryetari Begaj, priti udhëheqësin e ri të LMT-së në Malishevë

Malishevë, 4 prill



Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur sot, udhëheqësin e ri të njësies së LMT-së zvicerane në Malishevë, pjesë e KFOR-it , kapitenin Urs König. Ky takim kishte karakter njohës, pasi, kapiteni König, prej tani është udhëheqës i njësies së LMT-së zvicerane në Malishevë.

Në këtë takim, kryetari Begaj, e ka uruar kapitenin König, për detyrën e re, dhe i ka ofruar bashkëpunimin e Komunës së Malishevës. Kryetari Begaj, gjithashtu, e ka njoftuar ushtarakun zviceran me rrjedhat e përgjithshme në Malishevë, si dhe me faktin që Malisheva, vazhdon ta ketë primatin e komunës më të sigurt. Po ashtu Begaj, e ka falënderuar edhe paraardhësin e tij, për bashkëpunimin e mirë me komunën.

Udhëheqësi i deritanishëm i njësies së LMT-së, kapiteni Macoratti, e ka falënderuar kryetarin Begaj, për bashkëpunimin e mirë, si dhe e ka njoftuar me pasardhësin e tij, kapitenin Urs König.

Prej nesër, fillon trajtimi i qenve endacak

Malishevë, 4 prill

Prej nesër, në territorin e Komunës së Malishevës, do të filloj trajtimi i qenve endacak. Ky trajtimin do filloj, pasi Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillimi Rural, ka nënshkruar sot një marrëveshje me fondacionin zviceran “Stray Coco”, ndërsa nga nesër edhe fillon implementimi i kësaj marrëveshje, përmes së cilës, do të bëhet sterilizimi dhe kastrimi i qenve endacak.

Kjo marrëveshje është nënshkruar nga drejtori komunal për bujqësi Murat Hoxha dhe Blendi Bejdonit, përfaqësues i fondacionit “Stray Coco” në Kosovë.

Me të gjitha angazhimet për sterilizimin dhe kastrimin e qenve endacak, do të merret ky fondacion, duke filluar nga kapja, transporti deri në klinikë dhe të gjitha procedurat kirurgjikale për sterilizim dhe kastrim.

Këtë gatishmëri, e ka shprehur ky fondacion, pas përpjekjeve të drejtorit Murat Hoxha, për zgjidhjen e këtij problemi shqetësues. Mbikëqyrja e kësaj marrëveshje, do të bëhet nga Drejtoria për Bujqësi dhe Stacioni Policor në Malishevë.

Përndryshe, prania e jashtëzakonshme, e qenve endacak në territorin e Komunës së Malishevës, ka qenë një prej shqetësimeve kryesore, pasi numri i madh i tyre, ishte rrezik potencial për sigurinë fizike dhe shëndetësore. Përveç rrezikut nga kafshimet e mundshme, qytetarët kanë qenë të rrezikuar edhe nga bartja e viruseve të ndryshëm nga ana e qenve pa përkujdesje, si dhe bartja e insekteve të ndryshme, nga fusha në vendet e banuara, përfshi edhe bartjen e rrigrave.

Me këtë rast, Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Murat Hoxha, ju bën thirrje të gjithë atyre pronarëve që mbajnë qen në shtëpi, që të kujdesen për vendosjen e shenjave identifikuese për qen, siç janë rripat me qafore për qen, apo ti mbajnë të lidhur, në mënyrë që të mos kapen dhe të trajtohen bashkë me qentë tjerë endacak.

Projekti do të zgjatë deri në trajtimin e të gjithë qenve endacak.

Sot filloi aksioni i trajtimit të qenve endacak

Malishevë, 5 prill



Sot në territorin e Komunës së Malishevës, përkatësisht në qytetin e Malishevës, ka filluar aksioni për kapjen dhe trajtimin e qenve endacak. Ky aksion ka filluar nga ora katër e mëngjesit, e deri në ora 7:30 të mëngjesit. Aksioni është mbikëqyrur nga drejtoria komunale e bujqësisë dhe nga Policia e Kosovës.

Aksioni realizohet nga ekipi profesional, i caktuar nga fondacioni “Stray Coco”, e cila ka marrë përsipër trajtimin e qenve endacak. Sipas marrëveshjes, ky

fondacion, do të bëjë kapjen, bartjen në klinikën veterinare, për sterilizimin dhe kastrimin e qenve.

Ky projekt, do të zgjasë, deri në kapjen e të gjithë qenve pa përkujdesje, në territorin e Komunës së Malishevës.

Drejtori komunal për bujqësi, Murat Hoxha, ka bërë të ditur se aksioni i ditës së sotme ishte i realizuar në mënyrë profesionale dhe nuk është shënuar asnjë incident gjatë kapjes së qenve.

Hoxha, ka bërë të ditur, se gjatë ditëve në vazhdim, qytetarët, do të njoftohen me orarin e aksionit, në vendbanimet e Komunës së Malishevës. Po ashtu, Hoxha, ka bërë thirrje, për bashkëpunim nga ana e qytetarëve, si dhe ka përsëritur kërkesën, për pronarët e qenve shtëpiak, që të përkujdesen për qentë e tyre dhe ti mbajnë të lidhur ose t’iu vendosin shenjat identifikuese.

Komuna në aksion për pastrimin e qytetit

Malishevë, 5 prill



Punëtorët e administratës në Komunën e Malishevës, së bashku me kreun e komunës, Ragip Begaj, sot i kanë pastruar rrugët e qytetit dhe hapësirat e gjelbëruara në qytet, në kuadër të muajit prill, muaj i pastrimit në Komunën e Malishevës. Ky aksion, është organizuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Milazim Morina, ka bërë

të ditur se ky aksion, më shumë është simbolik dhe është një veprim i vetëdijesimit, për mirëmbajtjen e ambientit ku jetojmë, kurse muaji prill, edhe këtë vit do të jetë muaj i pastrimit.

“Gjatë muajit prill, kemi planifikuar ndërmarrjen e aksioneve të përbashkëta me njësinë e “Ekoregjionit” në Malishevë, për largimin e deponive ilegale të mbeturinave”, ka bërë të ditur drejtori Morina.

Infrastruktura e shkollës në Bellanicë, drejt përfundimit

Malishevë, 11 prill

Fshati Bellanicë i Malishevës, është një prej fshatrave, që ju ka ndryshuar pamja në tërësi, falë investimeve që janë duke u bërë. Krahas investime tjera në këtë fshat, është duke u rregulluar edhe oborri i shkollës, përkatësisht fusha e sportit, fushë e cila do ti përmbushë nevojat e shkollës dhe të rinjve të fshatit.

Gjatë ditës së hënë, është rregulluar pjesa e fushës, e cila do të jetë me standarde, përkatësisht është asfaltuar fusha, e cila përveç pjesës së futbollit të vogël, do të ketë edhe fushën për basketboll, hendboll dhe volejball.

Punimet në fushë, gjatë së djeshme i ka parë nga afër edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i urbanizmit Ahmet Morina, të cilët janë ndarë të kënaqur me punimet që janë duke u kryer.

Kjo fushë e cila është duke u rregulluar, i ka edhe tribunat dhe një pjesë të një amfiteatri të vogël, si dhe komplet kjo pjesë do të jetë e ndriçuar.

Përndryshe në Bellanicë, janë duke u kryer edhe disa projekte tjera në infrastrukturën rrugore.

Kryetari Begaj, vizitoi disa nga pemëtarët lokal

Malishevë, 12 prill



Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Murat Hoxha, sot kanë vizituar disa nga pemëtarët dhe pemištet, me qëllim të njohjes me punët pranverore që janë duke i bërë këta pemëtar, si dhe me nevojat dhe problemet që ata kanë, në kultivimin e pemëve.

Pjesa e vizituar sot ishte ish vreshtaria, tani pothuajse e

tëra e mbjellë me pemë të ndryshme. Ajo çfarë shihet në atë pjesë, është vërtetë mahnitëse, pasi disa qindra hektarë janë mbjellë me pemë, si mollë, kumbull, dardhë, arra, pjeshkë, mjedër dhe kultura tjera.

Gjatë bisedave me pemëtarë, kryetari Begaj, u njoftua me punët që tani po kryejnë në këto pemište, në mbrojtjen e pemëve nga sëmundjet e mundshme, që vijnë në këtë stinë të vitit dhe kur pemët janë në kulmin e lulëzimit.

Pemëtarët malishevas, paraqitën edhe nevojat e tyre para kryetarit Begaj, ku nevojë e domosdoshme është rregullimi i infrastrukturës dhe mundësia e ndërtimit të një frigoriferi, për ruajtjen e frutave të tyre. Vehbi Hoti, pemëtar, familja e të cilit aktualisht ka afro 75 hektar me mollë, tha se “kanë nevojë për rregullimin e rrugës, jo vetëm për pemišten e tyre, por për tërë kultivuesit që gjenden në këtë pjesë”.

Me këtë rast kryetari Begaj, ka thënë se janë duke i shqyrtuar mundësitë, për rregullimin e infrastrukturës rrugore, me qëllim të lëvizjes së pemëtarëve, si dhe mundësitë tjera për përkrahjen e këtyre pemëtarëve, me qëllim të rritjes së kapaciteteve të kultivimit të pemëve.

Kryetari Begaj, priti zyrtarët e OSBE-së

Malishevë, 13 prill

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur sot ekipin e OSBE-së. të udhëhequr nga Umit Aynaci, me të cilët kanë biseduar për bashkëpunimin e ndërsjellë, mes Komunës së Malishevës dhe OSBE-së, si dhe për mundësinë e organizimit të një projekti rajonal të bashkëpunimit, mes komunave, sidomos me rininë.

Pas ju uroi mirëseardhje përfaqësuesve të OSBE-së, kryetari Begaj, tha se “rinia është një sektor me interes të veçantë për Malishevës, dhe përkrahja nuk ka munguar asnjëherë dhe sigurisht se nuk dot mungoj”, përderisa i dha përkrahje edhe iniciativës së misionit të OSBE-së, për këtë këto aktivitete me karakter edukativ, rinor dhe kulturor.

Nga ana tjetër, Umit Aynaci, zyrtar i OSBE-së, e prezantoi projektin e OSBE-së, bashkëpunim ndërkomunal, me theks të veçantë rininë, ku shihen një varg aktivitete mes të rinjve nga të gjitha komunat e regjionit të Prizrenit, ku do të përfshihen të rinjtë nga të gjitha komunitetet.

Filloi rregullimi i këndit të lojërave në parkun e qytetit

Malishevë, 13 prill

Sot në Malishevë, përkatësisht në parkun e qytetit, ka filluar rregullimi i këndit të lojërave për fëmijë. Rregullimi i këtij këndi, është shumë i nevojshëm, pasi këndi i lojërave është dëmtuar nga koha dhe fëmijët nuk kanë se ku të argëtohen, gjatë qëndrimit në park. Fillimin e punimeve e kanë parë nga afër kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i shërbimeve publike, Milazim Morina.



Begaj dhe Morina, kanë kërkuar që ky kënd i lojërave të rregullohet sipas projektit të paraparë dhe fëmijët të kenë mundësi të mjaftueshme të argëtimit.

Sipas drejtorit Morina, do të vendosen edhe lojëra të përshtatshme për fëmijët, në mënyrë që ata të kenë mundësi të luajnë.

Përndryshe, rregullimi i këtij këndi, ka qenë kërkesë e fëmijëve, por edhe e prindërve, pasi parku është shumë i vizituar, por fëmijët nuk kanë se ku të argëtohen dhe rrjedhimisht e dëmtojnë edhe gjelbërimin në park.

Familja Kastrati në Turjakë, bëhet më shtëpi banimi

Malishevë, 14 prill



Falë shoqatës bamirëse “Ndhimo edhe Ti”, me donator Halim Hotin nga Carralluka, i cili jeton dhe vepron në Suedi, dhe Komunës së Malishevës, familja e Musaj dhe Bukurie Kastratit nga Turjaka, prej sot, përfundimisht e kanë të zgjidhur problemin e banimit, pasi janë bërë më shtëpi të re.

Sot, kësaj familje ju kanë dorëzuar çelësat e shtëpisë, e cila është ndërtuar falë donatorit Halim Hoti, përmes shoqatës humanitare “Ndhimo edhe Ti”. Shoqata e ka ndërtuar pjesën e mureve dhe meremetimin e brendshëm, ndërsa kulmin e shtëpisë e ka ndërtuar Komuna e Malishevës, në mënyrë që kjo familje të ketë një strehë normale për jetesë.

Liridon Llapashtica, drejtor i shoqatës, ka thënë se kjo shtëpi, sikur edhe shumë të tjera, janë ndërtuar falë donatorit Halim Hoti, të cilin e ka falënderuar për këto donacione, si dhe falë bashkëpunimit të mirë me Komunën e Malishevës. “Ne do të jemi, gjithmonë aty ku është nevoja dhe falë këtyre donacioneve dhe këtyre bashkëpunimeve me komuna, apo institucione tjera, do t’iu dalim në ndihmë familjeve që kanë nevojë”, ka thënë Llapashtica.

Ndërsa kryetari i Komunës së Malishevës, i cili mori pjesë në ceremoninë e dhënies së çelësave të shtëpisë për familjen Kastrati, e ka falënderuar shoqatën “Ndhimo edhe Ti” dhe në veçanti donatorin Halim Hoti. “Sot kjo familje e ka të zgjidhur problemin jetik të banimit, prandaj, i falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar dhe janë angazhuar në ndërtimin e shtëpisë”, tha Begaj.

Familja e Musaj dhe Bukurie Kastratit, janë katër anëtar, ndërsa për shumë kohë, kanë qenë pa shtëpi, mirëpo prej sot, ata e kanë zgjidhur përfundimisht problemin e banimit.

Filloi realizimi i dhënies së shujtës për nxënësit e shkollave në Malishevë

Malishevë, 18 prill

Në kuadër të realizimit të projekteve të miratuara në Kuvendin e Komunës së Malishevës, për vitin 2017, dhe në kuadër të rritjes së përkujdesjes në shkolla, prej sot ka filluar realizimi i



dhënies së një shujte për nxënësit e shkollave fillore, përkatësisht nga niveli parashkollorë, e deri në klasat e pesta.

Fillimin e realizimit të dhënies së shujtave, e kanë parë nga afër edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku dhe drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Avdi Morina, të cilët morën pjesë në dhënie të shujtave për nxënësit, në shkollën e fshatit

Lubizhdë.

Prej tani e deri në përfundim të vitit shkollor, dhënie të shujtës, do të kushtojë buxhetit të Komunës së Malishevës, afro katërdhjetë mijë euro, ku përfshihet shujta për 6 382 nxënësit.

Komiteti për Politikë dhe Financa, mbajti mbledhjen e pestë për këtë vit

Malishevë, 18 prill

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), nën drejtimin e kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Aziz Thaçi, ka mbajtur sot mbledhjen e pestë të radhës. KPF nga mbledhja e sotme, ka dhënë një varg rekomandimesh për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, në mesin e tyre edhe raportin e të hyrave dhe shpenzimeve në periudhën janar-mars 2017.

Po ashtu, KPF, ka rekomanduar për kuvend, edhe kërkesën për bartjen e të hyrave vetanake, nga viti fiskal 2015 dhe 2016, në vitin fiskal 2017. Për mbledhjen e ardhshme, është rekomanduar dhe informimi për punën e zyrës së Tatimit në Pronë, për vitin 2016, si dhe është rekomanduar edhe plani i punës së Zyrës së Prokurimit Publik për vitin 2017, pikë kjo e përsëritur.

Ndërsa rekomandimet tjera që u dhanë për kuvend, janë edhe një peticion i parashtruar nga banorët e fshatit Lladrovç, pastaj një kërkesë e Këshillit për kthimin e pronave të Bellanicës, pastaj një kërkesë e banorëve të lagjes së Gurit në Malishevë, kërkesa e kryesisë së fshatit Dragobil, për çeshtjen e deponisë për riciklim dhe asgjësim të mbeturinave, si dhe projekti i rrugës unazore në Malishevë, e cila është duke u ndërtuar.

Përurohet fusha e sportit në Llapçevë

Malishevë, 21 prill

Sot, me rastin e shënimit të ditës së shkollës “Petro Nini Luarasi” në Llapçevë, është bërë edhe hapja e fushës së sportit për këtë shkollë. Fusha e sportit në këtë shkollë, është ndërtuar në kuadër të rregullimit të infrastrukturës në shkollat e Komunës së Malishevës.



Në shënimin e ditës së shkollës, mori pjesë edhe drejtori i arsimit në Malishevë, Avdi Morina, i cili pasi i uroi nxënësit dhe mësimdhënësit, me rastin e ditës shkollës, tha se “krahas fushës së sportit, për këtë shkollë është rregulluar edhe kabineti i informatikës dhe shumë shpejt do të pajiset edhe me kompjuter” “Përkushtimi i Komunës së Malishevës është rritja e cilësisë në arsim dhe krijimi i kushteve sa më të mira për mësimdhënie dhe mësimnxënie dhe në kuadër të kësaj, janë bërë këto investime”, tha Morina.

Me rastin e shënimit të ditës së shkollës, në 158 vjetorin e lindjes së Petro Nini Luarasis, foli drejtori i shkollës, Aziz Avdiaj, ndërsa lidhur me këtë shkollë, drejtori Avdiaj, tha se janë të përkushtuar në rritjen e cilësisë në arsim. Drejtori gjithashtu falënderoi edhe Komunën e

Malishevës, për investimet në këtë shkollë, e në veçanti për fushën e sportit, e cila prej sot do të jetë në funksion.

Begaj e Zharku, nënshkruan një marrëveshje për financimin e dy projekteve

Prishtinë-Malishevë, 21 prill

Ministri i Infrastrukturës, Lutfi Zharku dhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, sot në Prishtinë, nënshkruan memorandumin e mirëkuptimit për financimin e dy projekteve infrastrukturore në komunën e Malishevës.

Me këtë Memorandum, Ministria e Infrastrukturës, do të financojë realizimin e asfaltimit të rrugëve në fshatin Llapçevë – Ujëvarat e Mirushës, në vlerë prej 250,000 eurosh dhe Mleqan – Pllaqicë në Malishevë, në vlerë prej 162,000 eurosh.

Ministria e Infrastrukturës, obligohet të sigurojë mjetet financiare për realizimin e këtyre projekteve, ndërsa Komuna e Malishevës, obligohet të sigurojë kushtet e nevojshme për realizimin e projekteve.

Mexhid Foniqi, falënderoi kryetarin Begaj, për përkrahjen e dhënë për komunitetin e të verbërve

Malishevë, 26 prill

Kryetari i Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, Mexhid Foniqi, ka qëndruar sot në Malishevë, përkatësisht në zyrën e kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, të cilin e ka falënderuar për përkrahjen e dhënë për komunitetin e të verbërve në Malishevë.



“Në emër të komunitetit të të verbërve, ju falënderoj për kontributin e dhënë për komunitetin e të verbërve në Malishevë”, tha Mexhid Foniqi, pa dhënies ceremoniale të letër falënderimit për kryetarin Ragip Begaj.

“Dëshiroj që kësaj kategorie, ti lehtësohen kushtet për jetë. Ne jemi përgjegjës që të kujdesemi për komunitetin e të verbërve dhe si komunë, do të bëjmë përpjekje që ti përkrahim këtë pjesë të shoqërisë”, tha Begaj.

Filloi ndërtimi i 50 serrave

Malishevë, 26 prill



Sot në Komunën e Malishevës, ka filluar realizimi i projektit për ndërtimin e serrave për pesëdhjetë bujq lokal. Realizimi i këtij projekti, bëhet në kuadër të investimeve të komunës, në bujqësi, me qëllim të rritjes së kapaciteteve të prodhimeve në perimekulturë. Në ceremoninë e fillimit të ndërtimit të serrave, mori pjesë edhe drejtori për bujqësi, Murat Hoxa, i cili uroi kultivuesit e perimeve.

“Ndërtimi i këtyre serrave, bëhet në kuadër të përpjekjeve të Komunës së Malishevës, për përkrahjen e bujqësisë në përgjithësi, me qëllim të zhvillimit dhe të rritjes së kapaciteteve prodhuese, në veçanti të perimeve të cilat rriten në serra”, tha drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Blegtori dhe Zhvillim Rural, Murat Hoxha.

“Bujqësia është dega më e fuqishme e zhvillimit ekonomik tek ne, prandaj edhe ne si qeverisje lokale, jemi duke i dhënë rëndësi të veçantë kësaj dege të ekonomisë, pasi kemi kushte ideale për zhvillim të bujqësisë në të gjitha fushat e saj. Rritja e kapaciteteve prodhuese, do të mundësoj edhe mbulimin e tregut të konsumit të perimeve, me perime vendore, që është qëllim kryesor i yni”, tha drejtori Hoxha, i cili edhe uroi njërin nga përfituesit e serrës, Shaip Morinën, nga Astrazupi.

Nga ana tjetër, bujku Shaip Morina, e ka falënderuar Komunën e Malishevës, për këtë përkrahje me rëndësi për të si bujk dhe për familjen në përgjithësi.

Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Murat Hoxha, ka sqaruar, se komuna ka subvencionuar pesëdhjetë bujq, në ndërtimin e serrave. “Ky projekt, do të kushtoj afër 45 mijë euro, ku pjesa më e madhe financohet nga Komuna e Malishevës, ndërsa edhe përfituesit e serrave, do të paguajnë një shumë prej rreth tridhjetë për qind. Serrat janë me një hapësirë prej një ari”, tha Hoxha.

Kryetari Begaj, priti në takim pune, zyrtarët e KEDS-it

Malishevë, 27 prill

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim pune, zyrtarët e KEDS-it, Avni Alidemaj dhe Agnes Furra, me të cilët kanë biseduar për investimet e KEDS-it në Malishevë. Me këtë rast, kryetari Begaj, edhe një herë ka shfaqur shqetësimin e tij për mos ndërtimin e trafos 110 kv.

Takimi kishte karakter informues, lidhur me investimet e KEDS-it në Malishevë, dhe me këtë rast zyrtarët e KEDS Alidemaj dhe Furra, e kanë informuar kryetarin Begaj lidhur me projektet e realizuara deri më tani dhe me projektet të cilat në realizmin dhe ato që pritet të fillojnë shpejt. Sipas tyre, janë realizuar disa projekte te rregullimit të infrastrukturës energjetike, si në Llazicë, Astrazup, pastaj në Mleqan është duke u realizuar një projekt, kurse shumë shpejt pritet të investohet në Dragobili 1 dhe Dragobili 2, kurse në proces janë projektet ne fshatrat Bubavec, Stapanica, Shkozë e Marali.

Edhe në këtë takim, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka kërkuar nga zyrtarët e KEDS-it, që të investohet në ndërtimin e trafo 110kv, projekt ky i premtuar edhe më herët, pasi fuqia aktuale e energjisë elektrike në Komunën e Malishevës, është e pamjaftueshme. “Pa një furnizim normal me energji elektrike, nuk mund të paramendohet as një zhvillim ekonomik, pasi çdo investitor e kërkon edhe energjinë elektrike”, ka thënë Begaj më këtë rast.

Kryetari Begaj, po ashtu ka kërkuar që KEDS të lëviz trafot në fshatrat Vërmice dhe Guncat.

KK i Malishevës, kërkon ndërprerjen e privatizimit dhe hetimin e procesit privatizimit të deritanishëm

Malishevë, 28 prill

Kuvendi i Komunës së Malishevës, ka filluar mbledhjen e katërt të rregullt, të cilën do ta vazhdoj në javën e ardhshme, pasi nuk kanë mundur ti përfundoj pikat e parapara për diskutim. Arsye e mos përfundimit të pikave të përcaktuara, ishte debati lidhur me kërkesat e komisionit komunal për shqyrtimin e kërkesave të fshatit Bellanicë dhe kërkesa e Këshillit të fshatit Bellanicë për kthimin e pronave të privatizuara në “Dubravë”.

Pas debat të gjatë, gati pesë orësh, dhe trajtimit të këtyre kërkesave, anëtrët e KK të Malishevës, kanë nxjerrë një kërkesë, drejtuar institucioneve shtetërore, përmes se cilës kërkohet ndërprerja e privatizimit të pronave të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe hetimin e procesit të privatizimit të deritanishëm.

Pas konsultimeve të shefave të grupe të subjekteve që përfaqësohen në KK Malishevës, është nxjerrë një kërkesë, të cilën e ka lexuar kryesuesi i KK të Malishevës, Aziz Thaçi.

Kërkesë:

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2017, pas debatit në seancën e katërt nxori këtë kërkesë, me të cilën kërkon nga organet e poshtëshënuara, që:

- 1) Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeverisë së Kosovës, Gjykatës Supreme-dhomës së posaçme, Prokurorisë së shtetit, Kryeprokurorit të shtetit, MAPL-së, që të merren të gjitha masat për ndërprerjen e të gjitha privatizimeve të pronës, se OPB “Mirusha”, si dhe ndërmarrjeve tjera në Komunën e Malishevës. Prokuroria e shtetit të inicioj hetime për procesin e privatizimit që ka nxitur debate deri në ditën kur parashtrohet kjo kërkesë, për privatizimet që kanë të bëjnë me pronat bujqësore në Komunën e Malishevës.*

Kërkesës ja bashkangjesim edhe materialin që e arsyeton kërkesën tonë.

Malishevës, 28 prill 2017.